



# RAPORTI I DHUNIMIT TË TË DREJTAVE TË PERSONAVE LGBT

Tiranë, Janar –Dhjetor 2014

© Ambasada PINK /LGBT Pro Shqipëri

# Dhunimi i të Drejtave të personave LGBT, 2014

**Raste të raportuara pranë Ambasadës PINK / LGBT Pro Shqipëri ose të monitoruara përmes Medias së shkruar dhe asaj vizive**

## Shkurt 2014

⇒ **RASTI 'A.F.'**

A.F. është paraqitur pranë zyrave të Ambasadës PINK në fillim të vitit 2012, i referuar prej psikologes së emisionit "Me zemër të hapur", të televizionit kombëtar NEWS 24, për të kërkuar informacion, ndihmë dhe mbështetje psiko-sociale. A.F., 46 vjeç, nga një qytet i vogël në jug të Shqipërisë, identifikohet si transgjinator (femër në trupin e një mashkulli).

I ndodhur në një situatë të vështirë, pa mbështetje, dhe me mirëkuptimin e pak njerëzve të cilët nuk duket se kanë mundësi të mëdha për ta ndihmuar, A.F. vendosi të dalë në fillim të vitit 2012 në emisionin e sipërpërmendur. Në këtë emision ai foli hapur për gjendjen e tij dhe kërkoi ndihmë. Psikologia e emisionit e këshilloi të drejtohet pranë Ambasadës PINK.

Që nga kontakti ynë i parë me A.F., ne jemi përpjekur të njohim historinë e tij, të identifikojmë nevojat dhe të gjejmë mënyra për ta ndihmuar. Prej marsit 2012 deri me tetor 2013 ne jemi përpjekur ta asistojmë me informacion, këshillim dhe mbështetje psikologjike.

Ne verifikuam se ai ndodhej në një proces të vështirë psikologjik, fizik dhe

emocional të tij, pikërisht për shkak të identitetit gjinor dhe daljes së tij hapur edhe në televizion. Gjendja e tij psikologjike u rëndua më shumë pas këtij emisioni pikërisht për shkak të paragjykitimit dhe diskriminimit nga komuniteti ku jetonte.

Ai në mënyrë të vazhdueshme ka vuajtur diskriminim nga ish-bashkëshortja dhe nga vajza e tij adoleshente për shkak të identitetit gjinor. Pas daljes së tij në televizion ai ka marrë kërcënime të vazhdueshme nga ish-bashkëshortja dhe i dashuri i saj që punonte me forcat e rendit. Gjithashtu A.F. pretendonte se gjatë procesit gjyqësor, pikërisht për shkak të identitetit të tij gjinor, i kanë vendosur kohën minimale për të takuar vajzën e tij, kohë që sipas përcaktimit ligjor u jepet prindërve të papërgjegjshëm, por që në rastin e Adriatikut një vendim i tillë ishte i pabazuar.

Gjithashtu, ai është diskriminuar edhe nga të afërmit, komuniteti i qytetit të tij, miqtë madje edhe nga përfaqësues të insitucioneve shtetërore ku është drejtuar (me keshillën e PE) për të denoncuar diskriminimin që po vuante nga ish-bashkëshortja dhe vajza e tij dhe për të kërkuar ndihmën e një avokati. Kjo ka bërë që A.F. të humbasë besimin edhe tek institucionet publike të cilat mund ta ndihmonin.

Për çka më sipër qëndrimi i tij në Shqipëri u bë i vështirë për por edhe për faktin se në Shqipëri aktualisht një person transgjinator nuk mund të ndiqet me terapi hormonale apo të kryejë operacione kirurgjikale për të ndërruar seksin e tij, gjë të cilën A.F. e dëshironte. Gjithashtu gjendja e tij u rëndua edhe për shkak të mungesës së suportit nga

grupe sociale transjinore të moshës së tij.

Në fillim të vitit 2014 A.F. largohet për në shtetin italian ku kërkon azil politik për shak të diskriminimit dhe paragjykitimit që vuante në Shqipëri.

Në muajin Shkurt 2014 PE kontaktohet nga avokatja e A.P. në Itali, për ta asistuar me një raport lidhur me konstatimin tonë për gjendjen dhe diskriminim që i ishte bërë A.F. në Shqipëri. Duke u bazuar në të dhënat e mbledhura nga takimet me A.F., gjatë frekuentimit të zyrave të AP prej tij, AP dërgon një raport pranë avokates së A.F. në Itali. Ende skemi informacione nëse A.F. ka mundur ta fitojë azilin apo jo.

## **Prill 2014**

### **⇒ RASTI 'N.K.'**

Më datë 16.04.2014 paraqitet pranë zyrave të PE, 19 vjeçarja N. K., nga një qytet në jug të Shqipërisë, e shoqëruar nga një mik i saj, frekuentues i PE. Arsyeja e vizitës kishte të bënte me kërkesën e saj për ta ndihmuar me strehim, pasi N. K. në mes të muajit shkurt ishte dhunuar dhe dëbuar nga shtëpia prej babait, për shkak të zbulimit të orientimit të saj seksual.

Ajo jetonte në Tiranë, me një shokun e saj në shtëpi me qera, por për shkak të mungesës së punës dhe të ardhurave ekonomike, skishin mundësi të vazhdonin të paguanin qeranë. N.K. ndihej e izoluar, e vetmuar, e frikësuar dhe e pasigurt për të ardhmen e saj.

PE i ofroi gjithë mbështetjen e saj si për informacion ashtu edhe për suport

psikologjik apo për ta orientuar se ku mund të interesohej për punë duke e ndihmuar të përgatiste një CV.

PE mori të dhënat e N. K. dhe të incidentit të ndodhur me babain. Ajo u informua se mund të bënte denoncim në polici apo ankesë në institucione të pavarura si KMD dhe AP për dhunën e ushtruar mbi të nga babai, por vajza refuzoi duke thënë se nuk donte ti acaronte më tej marrëdhëniet me familjarët. N. K. iu propozua që të merrte pjesë në aktivitetet socializuese që PE organizon dhe u asistua për gjetjen e një pune.

Tashmë N. K. ka gjetur një punë dhe ndjek aktivitetet argëtuese e socializuese të PE.

## **Maj 2014**

### **⇒ RASTI 'A.K.'**

Më datë 10.05.2014 në e/mail-in zyrtar të PE vjen një letër e hapur nga një anëtar i lëvizjes LGBT dhe drejtues i OMSA një prej organizatave më të reja në vend të të drejtave të njeriut që punon ndër të tjera edhe për avancimin e të drejtave të personave LGBT.

Përmes kësaj Letre të Hapur drejtuar nga A. K. tek të gjitha insitucionet dhe organizatat e të drejtave të njeriut në vend, ai donte të denonconte dhe ndante diskriminimin e hapur dhe përjashtimin që i ishte bërë si anëtar i komunitetit LGBT nga një organizatë LGBT (Aleanca kundër Diskriminimit LGBT).

Për shkak të shkeljeve dhe manipulimeve nga ana e organizatës, A.

K. ka hapur një padi në gjykatë kundër organizatës për shkeljet e kryera kundër punës së tij dhe të drejtave kontraktuale.

#### ⇒ RASTI 'ENEIDA TARIFA'

Pas fitimit të Eurovizionit nga këngëtari austriak Conchita Wurst i cili performoi i veshur si transvestit, këngëtarja e mirënjohur në vendin tonë Eneida Tarifa bën disa komente homofobike në faqen e saj në FB, më datë 9 Maj. Ajo shprehet se 'nuk është e këndshme për një shtet të ketë një përfaqësues të tillë. Si t'ia shpjegoj unë vajzës sime këtë fenomen që do të jetë përhapur?'

Menjëherë pas këtij komenti organizatat LGBT në vend reagues. PE informoi KMD për këtë rast duke i kërkuar fillimin e një hetimi ex-officio. Të njëjtën gjë ka bërë edhe Aleanca Kundër Diskriminimit LGBT. Ndërkohë të bashkuar pro kauzës LGBT reagues përmes një artikulli në faqen e tyre të web Historia ime.<sup>1</sup>

#### ⇒ RASTI 'KRESHNIK SPAHIU'

Gazetat ResPublika<sup>2</sup> dhe 'BalkanWeb'<sup>3</sup> të datës 10 Maj, publikojnë në faqet e

<sup>1</sup> <http://historia-ime.com/en/2011-08-07-02-53-55/item/4653-e-dashur-eneda-tarifa,-nga-kristi-pinderi.html>

<sup>2</sup> <http://respublica.al/artikuj/2014/05/10/kreshnik-spahiu-shqiperia-te-mos-lejoje-martestat-brenda-gjinise-rilindja-eshte>

<sup>3</sup> <http://www.balkanweb.com/shqiperi/2685/ak-spahiu-shqiperia-te-mos-lejoje-martestat-brenda-gjinise--edhe-rilindja-eshte-gay-188356.html>

tyre qëndrimin homofobik të Kreshnik Spahiut, kryetar i një prej partive nacionaliste në vend 'Aleanca Kuq e Zi', qëndrim të cilin ai e kishte bërë publik në një Konferencë për mediat, pas publikimit të lajmit për organizimin e Paradës së parë LGBT në Tiranë më 17 Maj.

Në këtë Konferencë kreu i AK, shprehet kundër martesave gay dhe paradave të LGBT. Në fjalën e tij Spahiu ka thënë se kjo shtresë, ky komunitet është niveli më i ulët në shoqëri duke e cilësuar si një "virus" të frikshëm. Sipas Spahiut vendi ynë nuk duhet ti lejojë martesa gay dhe nuk mund të lejojë manifestimin e imoralitetit në bulevardin që është larë me gjakun e dëshmorëve. Gjithashtu ai deklaronte se më 17 Maj, AK do të manifestonte kundër paradës LGBT, dhe pro familjes.

Pas këtij lajmi stafi i PE kontaktoi me përfaqësues të AK të cilët pohuan se këto deklarata kanë ardhur pas kërkesës që partia kishte marr nga anëtarët e tyre në diasporë dhe gjithashtu pohuan se ata përgatiteshin të zhvillonin një protest kundër paradës LGBT më 17 Maj.

PE u vu menjëherë në kontakt me Policinë e Tiranës për ti lajmëruar për rrishtun e anti-manifestimit më 17 Maj nga AK, të cilët synonin të ndalonin të drejtën e personave LGBT për të organizuar paradën. Policia mori të gjitha masat duke mos lejuar organizimin e këtij anti-manifestimi nga AK më 17 Maj, në të njëjtin vend dhe orë me paradën LGBT.

PE gjithashtu dërgoi një kërkesë pranë institucionit të Komisioneres për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ku i kërkon fillimin e një hetimi ex-officio për këtë rast.

⇒ **RASTI “PETICIONI I INTELEKTUALËVE ‘FAMILJE E SHËNDOSHË, ATDHE I SHËNDOSHË’”**

Ambasada PINK, u njoh me publikimin e një peticioni të nënshkruar nga 57 të ashtë-quajtur intelektualë, nën titullin “Familje e shëndoshë, atdhe i shëndoshë”, në faqen 7 të Gazetës Panorama, të datës 21 Maj 2014 dhe në gazetën Tema online të po të njëjtës datë.<sup>4</sup>

Ky peticion, nxiste publikisht urrejtjen kundër personave me orientim seksual dhe identitet gjinor LGBT, në Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoni, menjëherë pas organizimit të Paradës së parë gay në Shqipëri.

Po atë ditë PE reagon përmes një Deklarate Publike dërguar në të gjitha mediat e vendit dhe institucionet publike dhe jo-publike të të drejtave të njeriut në vend si një notë proteste ndaj peticionit i cili vetëm nxiste urrejtjen dhe homofobinë ndaj çdo personi LGBT dhe mbështetësve të tyre në Shqipëri. PE gjithashtu bën një kërkesë pranë institucionit të Komisioneres për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ku i kërkon fillimin e një hetimi ex-officio për këtë rast.

Ndërkohë një ditë më pas, më datë 22 Maj 2014, po në gazetën panorama, Dr. Agron Gjekmarkaj, emri i të cilit ishte publikuar zyrtarisht si nënshkruar i peticionit prej 57 personash, deklaroi

<sup>4</sup> <http://www.gazetatema.net/web/2014/05/21/lista-59-intelektuale-nenshkruaje-peticionin-pro-familjes-kunder-homoseksualeve/>

publikisht se ai nuk ishte nënshkruar i tij.<sup>5</sup>

Po në datë 22 Maj 2014, në versionin on-line të gazetës Panorama ([www.panorama.com.al](http://www.panorama.com.al)) tek artikulli i botuar në datë 21 Maj në lidhje me peticionin, nga versioni original i 57 intelektualëve nënshkruar, hiqen pa asnjë shpjegim dy emra: Agron Gjekmarkaj dhe Alfred Lela (zv.kryeredaktor i Gazetës MAPO).<sup>6</sup>

Pas kësaj, PE më datë 26 Maj 2014 dërgon një kërkesë zyrtare drejtuar Prokurorit të Përgjithshëm të Shqipërisë, për fillimin e hetimeve për mashtrim dhe nxitje urrejtje për autorët e peticionit “Familje e Shëndoshë, atdhe i shëndoshë”. Për dijeni kjo kërkesë j’u dërgua edhe institucioneve publike dhe të pavaruar në vend për të drejtat e njeriut si edhe tek agjensitë dhe ambasadat e huaja në vend.

⇒ **RASTI ‘SIMPOZIUMI I KOMUNITETEVE FETARE NË VEND’**

Ambasada PINK u njoh me artikullin ‘Homoseksualizmi një e keqe kërcënuese, familja shqiptare në rrezik’, publikuar në faqen 6, të Gazetës MAPO, të datës 26 Maj.<sup>7</sup> Ky shkrim bën fjalë për një simpozium të organizuar nga

<sup>5</sup> <http://www.panorama.com.al/2014/05/22/teknologjia-e-fabrikimit-te-peticioneve/>

<sup>6</sup> <http://www.panorama.com.al/2014/05/21/peticioni-57-intelektuale-pro-familjes-kunder-gay-ve-mos-i-jepni-mbeshtetje-publike-devijimit-te-shendetit/>

<sup>7</sup> <http://mapo.al/2014/05/komunitetet-fetare-ne-nje-qendrim-homoseksualizmi-nje-e-keqe-kercenuese-familja-shqiptare-ne-rrezik/>

komunitetet fetare në vend të cilat ishin bërë bashkë në këtë aktivitet për të dhënë një mesazh pro familjes, pas Paradës së komunitetit LGBT të datës 17 Maj, të cilën ata e kanë cilësuar si një sulm ndaj familjes.

Në këtë simpozium, gjithmonë sipas artikullit të gazetës, ka qenë prezent edhe z. Ilir Hoxholli, Kryetar i Komitetit Shtetëror të Kulteve, insitucion varësie i MMSR, i cili gjithashtu ka bërë deklarata fyese ndaj komunitetit LGBT dhe të papranueshme nga një zyrtarë publik.

PE ka reaguar përmes një letrë-ankese dhe kërkesë dërguar këshilltares së Ministrit të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë ku i kërkon vërtetimin e fjalëve të zyrtarit përmes vënies në dispozicion të fjalimit të tij apo minutave të simpoziumit dhe distancimin prej këtyre deklaratve nëse janë të vërteta, pasi komuniteti LGBT pret nga institucionet shtetërore që ato të mbrojnë të drejtat e çdo personi dhe jo ti dhunojnë ato.

Dy organizatat e tjera LGBT në vend, Alenaca LGBT dhe Të bashkuar pro kauzës LGBT, gjithashtu kanë reaguar ndaj këtij simpoziumi përmes një deklaratë publike duke u shprehur se komuniteti LGBT nuk është në luftë me komunitetet fetare dhe ku shprehin indinjatën e tyre ndaj fjalëve të zyrtarit publik të Komitetit Shtetëror të Kulteve.<sup>8</sup>

### ⇒ RASTI 'DEPUTETËT E DJATHTË'

Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë i ka propozuar Ministrisë së

<sup>8</sup> <http://mapo.al/2014/05/komunitetet-fetare-ne-nje-qendrim-homoseksualizmi-nje-e-keqekercenuese-familja-shqiptare-ne-rrezik/>

Drejtësisë ndërmarrjen e një ndryshimi në Kodin e Familjes, që mundëson njohjen e partneriteteve nga komuniteti LGBT përpara një noteri. Deklarata është bërë nga ministri i Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, Erion Veliqaj, gjatë raportimit në Komisionin parlamentar të Integritimit Evropian të datës 27 Maj.

Në kuadër të masave antidiskriminim, Veliqaj bëri me dije se MMSR ka përfunduar dhe nisur për miratim një ndryshim në Kodin e Punës, që synon mbrojtjen e qytetarëve ndaj çdo lloji diskriminimi në vendin e punës si rrjedhojë e orientimit seksual të personit. Gjithashtu, në këtë kuadër është nënshkruar edhe deklarata IDAHO, për avancimin e të drejtave të komunitetit LGBT.

Portali Historia ime<sup>9</sup>, në po këtë datë publikon në faqen e tij se z. Genc Ruli, deputet i Partisë Demokratike dhe anëtar i Komisionit Parlamentar të Integritimit Evropian ka replikuar me Veliqajn gjatë raportimit duke i thënë: "Të konsiderosh si të drejta prioritare ato të grupeve LGBT, apo Rome dhe Egjyptiane, nuk e di. Ju duhet të raportoni për të drejtën e pronësisë. Çdo parlamentar ka të drejtën e vet të vendosë prioritet në fushën e të drejtave të njeriut, por është e rëndësishme që të kuptohet se në fund të ditës ajo që e përcakton nëse një çështje është prioritet për shtetin ose jo, ka të bëjë dhe me buxhetin që alokohet".

Ndërsa z. Tritan Shehu, deputet i Partisë Demokratike ka reaguar në faqen e tij

<sup>9</sup> <http://historia-ime.com/en/component/k2/item/4731-shenim-mbi-repliken-e-deputetit-ruli-me-ministrin-veliqaj-per-lgbt.html>

në FB, e publikuar nga disa të përditshme të datës 28 Maj<sup>10</sup> duke e cilësuar propozimin e ministrit të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, Erjon Veliaj si prekje të Kodit të Familjes dhe njohje de facto të martesave Gay e LGBTB.

Sipas Shehut ky propozim është tritol në themelin e familjes dhe për shoqërinë njerëzore e vlerat e saj. Ai citon “Kodi ynë i Familjes është shumë i qartë. Ai nuk mund të deformohet. Ai është në përputhje me të drejtën, moralin, thelbin e familjes dhe me natyrën e vetë shoqërisë. Ai është në përputhje me shumicën dërrmuese të vendeve të tjera”. Të luftosh diskriminimin është tjetër gjë. Ne kemi një ligj për këtë. Të luftosh diskriminim nuk do të thotë të shkatërrosh familjen. Familja është e shenjtë. Të prekësh familjen do të thotë të shkatërrosh të kaluarën, të sotmen e të ardhmen. Ne nuk duhet ta lejojmë këtë deformim shumë të rrezikshëm”.

Gjithashtu znj. Mesila Doda, deputete e PD-së, ka reaguar ashpër ndaj

---

<sup>10</sup><http://www.panorama.com.al/2014/05/28/veliaj-njohje-partenitetit-gay-shehu-tritol-themelit-te-familjes-njohje-de-facto-e-martesave-gay/>

<http://www.balkanweb.com/kryesore/1/propozimi-i-veliajt-shehu-njohje-de-facto-e-martesave-gay-e-lgbt-tritol-familjes-191896.html>

<http://www.civitas.al/al/vendi/propozimi-i-veliajt-shehu-njohje-de-facto-e-martesave-mes-homoseksualeve>

[http://time.ikub.al/9dfdce5fd9/d8ddf9cdcdc90b8a3e971ab9fbf468a5/Lajm\\_Sherr-mes-deputeteve-per-martesat-gay.aspx](http://time.ikub.al/9dfdce5fd9/d8ddf9cdcdc90b8a3e971ab9fbf468a5/Lajm_Sherr-mes-deputeteve-per-martesat-gay.aspx)

[http://time.ikub.al/9dfdce5fd9/b8079afb12dba35febf212416cf215a4/Lajm\\_Shehu-Kodi-yne-i-Familjes-eshte-i-shenjte-nuk-mund-te-deformohet.aspx](http://time.ikub.al/9dfdce5fd9/b8079afb12dba35febf212416cf215a4/Lajm_Shehu-Kodi-yne-i-Familjes-eshte-i-shenjte-nuk-mund-te-deformohet.aspx)

propozimit të z. Veliaj, në gazetën ‘Shqip’, të datës 29 Maj<sup>11</sup>. Ajo deklaroi se mbetet te familja tradicionale. “Unë jam pro familjes tradicionale. Deklaroj se koncepti i rilindjes së Veliajt është krejt i kundërt me konceptin tim që mbështetet në atë akt dashurie që Zoti solli në tokë, familjen e bazuar mbi lidhjen e një burri dhe një gruaje, që mbështetin rritjen dhe shumimin e jetës në botë. Do ftoj që të bëjmë së bashku, politikanë, deputetë dhe cilindo tjetër nga të gjitha krahët e politikës një front të përbashkët kundër tjetërsimit të konceptit të familjes dhe imponimit të një fryme që në emër të ‘tolerancës’ kërkon të sjellë me forcë, shantazh dhe lobim personal pushtetarësh, tjetërsimin e bazës së shoqërisë sonë njerëzore”.

Deklaratat dhe qëndrimet e deputetëve tregojnë një frymë ta hapur homofobie dhe diskriminimi duke kërkuar që komuniteti LGBT në vend të përjashtohet nga një e drejtë themelore siç është ajo e të pasurit dhe të krijuarit të një familje me partnerin të cilin dashuron.

## Shtator 2014

⇒ RASTI ‘A.L.’

Më datë 05.09.2014, paraqitet pranë zyrave të PE A. L., 27 vjeç, vajzë-nënë, me fëmijën e saj 10 muajsh.

Për shkak të orientimit të saj seksual në fillim të vitit 2013, A.L. është përdhunuar por nuk e ka denoncuar përdhunimin nga frika e paragjyqimit. Si

---

<sup>11</sup> <http://gazeta-shqip.com/lajme/2014/05/29/doda-koncepti-rilindjes-kundert-ate-te-familjes/>

pasojë e këtij përdhunimi vjen në jetë një fëmijë djalë.

Që pas lindjes së fëmijes A.L. ska pasur asnjë lloj mbështetje nga familjarët e saj. Ajo nuk pranohet dhe kërcënohet nga i jati dhe vëllai i madh. Shoqata Arsis e ka mbështetur duke i ofruar ndihmë financiare për pagesen e qerasë së shtëpisë për 6 muaj si edhe me ndihma ushqimore për fëmijën e saj.

A.L. drejtohet pranë PE për të kërkuar mbështetje dhe ndihmë pasi nuk ka mbështetjen e familjes së saj, apo një pune për të siguruar të ardhura për veten dhe fëmijën. Kjo për shkak të orientimit të saj seksual.

A.L. ka nevojë për punë dhe strehim, por dëshira kryesore e saj është të largohet nga vendi së bashku me fëmijën, sepse sipas saj në Shqipëri ndihet e diskriminuar në rrugë, në familje, për gjetjen e një pune, etj.

Ajo tregon se është drejtuar edhe pranë zyrave të punës por është ndier e diskriminuar prej tyre, çështje që e ka çuar edhe pranë KMD. Sipas saj edhe pse është interesuar për të përfituar nga ndihma ekonomike deri tani nuk ka mundur të përfitoj asgjë. A.L. nuk pranon të qëndroj në një strehëz pasi mendon se aty i kufizohet liria fëmijës.

PE i ofroi gjithë mbështetjen e saj si për informacion ashtu edhe për suport psikologjik apo për ta orientuar se ku mund të interesohej për gjetjen e një pune.

Gjithashtu PE e referoi rastin pranë një organizate që ofron mbështetje në ndihma ushqimore dhe ekonomike për fëmijët jetimë. A.L. u asistua nga organizata me paketa ushqimore.

## AZILKËRKUESIT

Gjatë këtij viti, ashtu sikurse edhe vitet e mëparshme, pranë zyrave të PE janë paraqitur raste të personave LGBT të cilët kërkojnë të largohen nga Shqipëria dhe të asistohen me informacion lidhur me azilkërkuesit në vende të ndryshme të Europës, veçanërisht Suedi dhe Hollandë. Arsyet kryesore të dëshirës për tu larguar kanë të bëjnë me a) diskriminimin e tyre në familje e shoqëri për shkak të orientimit të tyre seksual apo identitetit gjinor, b) pamundësinë e gjetjes së një pune, c) pamundësinë e një jete të lirë e dinjitoze, d) pamundësinë e legalizimit të lidhjeve të tyre me partnerët në martesë, e) kërcënimeve dhe dhunës së ushtruar ndaj tyre, f) mungesës së strehimit apo shërbimeve të tjera për personat LGBT të dëbuar nga shtëpitë e tyre.

Por gjatë këtij viti ka pasur gjithashtu edhe raste të personave LGBT të ardhur nga shtete të tjera në Shqipëri të cilët dëshironin të kërkonin azil në vendin tonë dhe janë drejtuar pranë Ambasadës Pink për tu asistuar me informacion rreth institucionit dhe mënyrës sesi mund të kërkohet azil.

### ⇒ Rasti A.L.

A.L, 27 vjeçe, nënë e një fëmije kërkonte të largohej nga Shqipëria së bashku me fëmijën, sepse sipas saj në Shqipëri ndihet e diskriminuar, e kërcënuar dhe e papranuar në rrugë, në familje, për gjetjen e një pune, etj, për shkak të orientimit të saj seksual.



### ⇒ Rasti M.

Një 29 vjeçar nga një qytet në jug të Shqipërisë (Vlora), M. gjithashtu kërkonte të largohej jashtë vendit sepse së bashku me partnerin e tij shpesh është rrahur në rrugë, paragjykuar e diskriminuar nga shoqëria pikërisht për shkak të orientimit seksual. Sipas tij në Shqipëri nuk mund të bëjë një jetë të lirë dhe të qetë së bashku me partnerin dhe gjithashtu nuk do të krijohej kurrë mundësia për ta legalizuar lidhjen e tyre në martesë. Për shkak të diskriminimit dhe kërcënimeve ai nuk mundet dot të gjejë një punë në Shqipëri.

### ⇒ Rasti 'transgjinator'

Persona nga komuniteti transgjinator në vend gjithashtu kërkojnë të largohen nga vendi pasi ndihen të diskriminuar në mënyrë të shumëfishtë, për shkak të identitetit gjinor, klasës shoqërore të cilës i përkasin dhe racës. Duke qenë më të dukshëm por edhe për shkak të punës që bëjnë si punonjës seksi, persona e komunitetit transgjinator, janë shpesh pre e dhunës dhe kërcënimeve të drejtpërdrejta nga grupe personash homofobë. Komuniteti transgjinator është pa strehim, punë dhe shërbime të tjera mbështetëse, është komuniteti i cili diskriminohet më shumë dhe hapur në vend.

### ⇒ Rasti 'shtetasi kamerunez'

Më datë 1.12.2014, paraqitet pranë zyrave tona, C. M. A., shtetasi kamerunez, i pajisur me leje qëndrimi 2 vjeçare në vendin tonë.

C. kërkonte asistencë nga PINK për ta orientuar tek institucionet shqiptare të cilat mund ti sigurojnë azil në vendin tonë, pasi ai nuk mund të kthehet në

Kamerun për shkak të diskriminimit që pëson atje nga familjarët dhe të tjerë, për shkak të orientimit të tij seksual.

Kontakti i C. me Ambasadën Pink ka filluar që në muajin Korrik 2014. Si fillim C. kërkoi nga PINK asistencë për gjetjen e një pune. PINK, e orientoi drejt një call center dhe e asistoi në përgatitjen e një CV-je personale për ta paraqitur tek punëdhënësit.

Ndërkohë në muajin Dhjetor, C. kontakton përsëri me stafin e Pink për ta orientuar drejt autoriteteve shtetërore për të kërkuar azil. C. raporton diskriminim dhe refuzim nga ana e familjarëve të tij për shkak të orientimit të tij seksual. Për këtë arsye ai është shpëputur nga familja prej 17 vjetësh dhe e ka të pamundur të kthehet përsëri atje.

PINK e asistoi duke i shpjeguar se ku duhet të drejtohej për të bërë kërkesën për azil dhe një person nga stafi e shoqëroi pranë Policisë Kufitare. Në këtë institucion C. mori gjithë informacionin e nevojshëm sesi ai mund të qëndronte në vendin tonë dhe të aplikonte për të marrë nënshtetësinë shqiptare.

---

Përgatitur nga: Blerina Metaj,  
Koordinatorë Programi,  
[blerina.metaj@crca.al](mailto:blerina.metaj@crca.al)

Redaktuar dhe përkthyer në anglisht nga: Amarildo Fecanji,  
Drejtor Programi  
[amarildo.fecanji@crca.al](mailto:amarildo.fecanji@crca.al) & [amarildofecanji@gmail.com](mailto:amarildofecanji@gmail.com)

Ambasada PINK / LGBT Pro  
Rr. Perlat Rrexhepi, Pll "ANA", Kati VII, Ap. 18  
P.O Box 1738  
Tiranë, Shqipëri  
Telefon: +35542265741  
Email: [pinkembassy@crca.al](mailto:pinkembassy@crca.al)  
Web: [www.pinkembassy.al](http://www.pinkembassy.al)